



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 87/2018

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PARLAMENTAR “PËR NDJEKJEN DHE
MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 12/2018 “PËR VLERËSIMIN
KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT,
GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME
DHE ANKESAT””, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
TË KUVENDIT PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 67, të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Ngrihet Nënkomisioni parlamentar “Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme””.

II. Nënkomisioni organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet, në përbërje të Komisionit të përhershëm të Kuvendit për Sigurinë Kombëtare.

III. Fusha e përgjegjësisë së këtij Nënkomisioni është ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”.

IV. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

1. Ermonela Valikaj (Felaj)	Kryetare	(PS)
2. _____	Zëvendëskryetar	(PD)
3. Pjerin Ndreu	Anëtar	(PS)
4. Elona Hoxha	Anëtare	(PS)
5. Sadi Vorpsi	Anëtar	(PS)

6. _____ Anëtar (LSI)
7. _____ Anëtar (PD).

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 19.7.2018